



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2018-01

Vendos: Gjykatësi i vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Dr. Fidelma Donlon

Data: 25 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

1. Në përputhje me rregullën 55(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullorja')¹, kur një person arrestohet në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar prej Dhomave të Specializuara, autoritetet kompetente informojnë pa vonesë Administratorin, i cili njofton menjëherë Kryetarin, panelin dhe palët. Në përputhje me sa më lart, Administratorja njofton për arrestimin e z. Nasim Haradinaj ('z. Haradinaj') në Kosovë prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('ZPS').
2. Më 24 shtator 2020, gjykatësi i vetëm lëshoi një vendim rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në të cilin miratoi kërkesën e ZPS-së për lëshimin e një fletarrestimi dhe urdhri për transferim ('vendimi për arrestim dhe transferim').² Në vendimin për arrestim dhe transferim, gjykatësi i vetëm urdhëroi ZPS-në që të kryente dorëzimin dhe zbatimin e fletarrestimit në Kosovë.³
3. Më 25 shtator 2020, afërsisht rreth orës 16:10, ZPS-ja informoi Administratoren se z. Haradinaj ishte arrestuar nga ZPS-ja në Kosovë më 25 shtator 2020.
4. Në përputhje me vendimin për arrestim dhe transferim, Administratorja do t'i dorëzojë gjykatësit të vetëm raport lidhur me arrestimin dhe transferimin e z. Haradinaj.⁴
5. Ky njoftim parashtrohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, në përputhje me klasifikimin aktual të vendimit për arrestim dhe transferim.

Numri i fjalëve në origjinal: 249

/nënshkrim/

Dr. Fidelma Donlon
Administratore

E enjte, 25 shtator 2020

Në Hagë, Holandë

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020.

² Vendim mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave për transferim, KSC-BC-2018-01/F00128, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2018-01/F00128, para. 36(c).

⁴ KSC-BC-2018-01/F00128, para. 36(f).